



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/2018

PËR

NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8668, DATË 23.10.2000,
“PËR PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË ME PASAPORTË
PËR JASHTË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 11, i ligjit nr.8668, datë 23.10.2000, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 11

Ripajisja me pasaportë biometrike e shtetasve

1. Shtetasi ripajiset me pasaportë biometrike:
 - a) në rastet e përcaktuara në nenin 9, të këtij ligji;
 - b) kur pasaportës i ka mbaruar afati i vlefshmërisë;
 - c) 6 (gjashtë) muaj përpara mbarimit të afatit të vlefshmërisë, kur udhëton apo qëndron përkohësisht në shtete që kushtëzojnë hyrjen ose qëndrimin me afatin 6-mujor (gjashtëmujor) të vlefshmërisë së pasaportës.
2. Procedura për ripajisjen me pasaportë biometrike të zakonshme dhe dokumentacioni që paraqitet përcaktohen me udhëzim të ministrit të Brendshëm.”.

Neni 2
Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet ministri i Brendshëm, që, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë udhëzimin, në zbatim të nenit 1, të këtij ligji.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI